



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 714/6 Prot.

Tiranë, më 22.11.2018

VENDIM

Nr. 93, datë 22.11.2018

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË
NËPËRMJET KËRKESËS SË NËPUNËSIT ***** , PROTOKOLLUAR ME
NR. 714 PROT., DATË 14.9.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore tëparashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dokumentar të mbledhur për verifikimin e informacionit që përmbante kërkesa e nëpunësittë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, *****,

VËREJ SE:

Nëpunësi ***** , me detyrë “Inspektor, në Sektorin e Skemave Kombëtare”, në Drejtorinë e Kontrollit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, nëpërmjet një kërkesë drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, regjistruar me nr. 714 prot., datë 14.9.2018, ka ngritur pretendimin se gjatë realizimit tëprocedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2018, janë kryer dhe lejuar veprime të cilatvijnë në kundërshtim mekërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar.

Nga trajtimi i këtij rasti, rezultoi se, në kuadër të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave kryesore të punës, si dhe aftësive e dobësive të nëpunësit për kryerjen e detyrave, për nëpunësin ***** , nga ana e eprorëve të tij është kryer

procesi ivlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor 2018, në përfundim të të cilit është dhënë vlerësimi në nivelin 4, “Jo kënaqshëm”.

Nëpunësi *****, parashtron se nuk ka qenë dakord me vlerësimin dhe pavarësisht se këtë nuk e ka pasqyruar nëpërmjet shënimeve përkatëse, në pikat 4 dhe 5, të ndarjes D: “Nënshkrimi”, të formularit, bazuar në pikën 1, të Kreut V, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar, ka ushtruar të drejtën e ankimit, veprim i cili gjen pasqyrim, në shkresën nr. 3628 prot., datë 4.9.2018, drejtuar titullarit të institucionit.

Ky i fundit, në cilësinë e zyrtarit autorizues, në zbatim të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhej që brenda 5 ditëve, të shqyrtonte pretendimet e nëpunësit dhe të bënte rivlerësimin përkatës, i cili shënohet dhe nënshkruhet prej tij, në ndarjen përkatëse të formularit të vlerësimit, (ndarja DH e lidhjes).

Konstatohet se zyrtari autorizues, nuk e ka marrë në shqyrtim këtë ankim dhe nuk ka bërë rivlerësim të rezultateve në punë të nëpunësit në fjalë, ç’këmbie ndesh me përmbajtjen enenit 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar dhe cenon të drejtat legjitime të nëpunësit.

Dispozitat e mësipërme përcaktojnë se, sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces administrativ i cili ka të bëjë me verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil, si dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Në kuptim të Kreut II, pika 12, të vendimit nr. 109, dat 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, që kryhet bashkarisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues e zyrtari autorizues duke respektuar fazën e planifikimit, e cila përmban caktimin e objektivave kryesorë të punës dhe sjelljet profesionale të nëpunësit, që do të bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, etj; fazës së bisedimeve të ndërmjetme, ku përfshihen takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen gjatë periudhës së vlerësimit, ku zyrtari raportues midis të tjerave vlerëson edhe progresin në arritjen e objektivave të planifikuar dhe faza e vlerësimit përfundimtar.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të rastit të vlerësimit të nëpunësit ******, rezulton se procedura e përcaktuar në aktet e mësipërme nuk është respektuar, pasi nuk është evidentuar asnjë dokumentacion që materializon zhvillimin e fazave nëpër të cilat kalon procedura e vlerësimit të rezultateve në punë. Ky fakt pasqyrohet në mungesën e komenteve në shumicën e rubrikave të formularit të vlerësimit (*veçanërisht ndarja Ç, "Sjelljet profesionale", nuk është e shoqëruar me asnjë koment*) dhe në mungesën e besueshmërisë së konkluzioneve të arritura në fund të procesit, pasi nuk janë të mbështetura në prova.

Procedura e vlerësimit të nëpunësit civil, sipas formatit të miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, krahas vlerësimit me pikë, përmban detyrimin e plotësimit të komenteve përkatëse në lidhje me vlerësimin përfundimtar, arsyet e këtij vlerësimi si dhe rekomandimet dhe vërejtjet e nevojshme, me qëllim ngritjen e nivelit të shërbimit dhe arritjen e rezultateve dhe objektivave të përcaktuara. Respektimi i këtij detyrimi ligjor, ndikon në një vlerësim objektiv dhe të efektshëm të performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe për më tepër, ndihmon nëpunësin që në të ardhmen të përqendrohet në ato drejtime të treguara, me qëllim përmbushjen sa më mirë të detyrave dhe nxitjen e rritjes së rezultateve në punë

Duke analizuar përmbajtjen e formularit të vlerësimit, të nëpunësit ******, konstatohet se në cilësinë e *Zyrtarit raportues* dhe *"Zyrtarit kundërfirmues"*, janë paraqitur nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, me detyrë specialist/inspektor, të cilëve ndjekja e detyrave të përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit të drejtorisë, iu është ngarkuar si detyrë shtesë, e përkohshme, me urdhër të titullarit të institucionit, që vjen në kundërshtim me parashikimet e shkronjave "b" dhe "c", të pikës 2, të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, i ndryshuar, ku në mënyrë të shprehur përcaktohet se, *"Zyrtar raportues"*, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë, në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet, ndërsa, *"Zyrtari kundërfirmues"*, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike zyrtarin raportues.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin ******, ka elementë paligjshmërie, pasi nuk është kryer sipas kërkesave të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë"*, i ndryshuar.

Në lidhje me procesin e vlerësimit, në institucionin e AZHBR-së, janë konstatuar qëndrime dhe veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit, edhe në raste të tjera, ç'ka është materializuar në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes në këtë institucion dhe në Vendimin e Paralajmërimit për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil, nr. 82, datë 4.10.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në këto akte është lënë detyrë që, **a)** “...nëpunësit të cilët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të kujdesen që ky proces për nëpunësit civilë, të përmyllet duke respektuar të gjitha procedurat e hollësishme të përcaktuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar. (Në rastin konkret, nëpunës të përfshirë në procesin e vlerësimit janë nëpunësit e emëruar “me detyra shtesë” në pozicionet përgjegjës sektori, drejtor drejtorie, titullar institucioni si dhe njësia e burimeve njerëzore); **b)** *formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, i cili plotësohet çdo 6 muaj brenda vitit kalendarik, apo në përfundim të periudhës së provës, është dokument që krijohet dhe miratohet nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit dhe në këtë rast, duhet të plotësohen në mënyrën e duhur të gjitha ndarjet dhe elementet formalë të kërkuara nga formulari i vlerësimit.*”

Nisur dhe nga konkluzionet dhe detyrat e lëna në aktin e mësipërm, kjo mënyrë të vepruari e drejtuesit të institucionit të AZHBR-së dhe njësisë së saj të burimeve njerëzore, vjen në kundërshtim me ligjin dhe ka sjellë si rrjedhojë nxjerrjen e akteve të kundraligjshme, të cilat është e nevojshme të rregullohen në mënyrë nominale.

Konkretisht, akti i vlerësimit për nëpunësin *****, vlerësohet i kundraligjshëm për arsyet e mëposhtme:

1. Akti, nuk është përpiluar dhe nënshkruar nga ato subjekte që përcaktohen në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Arrihet në këtë përfundim, pasi punonjësit që janë paraqitur në rolin e “nëpunësit raportues” dhe në atë të “nëpunësit kundërfirmues”, nuk i gëzojnë ato cilësi në kuptimin e legjislacionit të shërbimit civil. Mënyra e “komandimit” të tyre, nëpërmjet dhënies së detyrave “shtesë”, nuk njihet nga legjislacioni i shërbimit civil. Konkretisht, pika 1, e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pika 2, e Kreut I, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, në rastet kur paraqiten nevoja të tilla, njohin vetëm transferimin e përkohshëm, deri në 6 muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë dy viteve, brenda dhe në interes të institucionit, me kusht **ruajtjen e kategorisë së nëpunësit**. Pra, nuk është e lejueshme, transferimi (nuk parashikohet ngarkimi me detyra të përkohëshme) i nëpunësve me një nivel më të ulët kategorie në shërbimin civil, për të kryer detyra të një niveli më të lartë, pasi prezumohet që nuk ka formimin, kualifikimin dhe eksperiencën e nevojshme, për të kryer një detyrë të tillë.

Edhe më e dukshme është kjo në rastin e nëpunësit *****, i cili ndonëse është pranuar në shërbimin civil në datën 22.12.2017 (në periudhë prove) në pozicionin,

“Inspektor në sektorin e kontrollit IPARD”, në Drejtorinë e Kontrollit në AZHBR (shih aktin e emërimit nr. 3222 datë 22.12.2017 të DAP), pas disa ditësh, me aktin nr. 3336/1, datë 26.12.2017, i është ngarkuar detyra shtesë e Drejtorit të Kontrollit. Pika 3, shkronja “a”, e Vendimit nr.125 datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, e ndalon në mënyrë të shprehur, transferimin e përkohshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove, qoftë edhe brenda kategorisë.

Mosmarrja e masave për plotësimin e këtyre pozicioneve të lira, në mënyrën e kërkuar nga ligji, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, është një e metë e konstatuar edhe gjatë procesit të mbikëqyrjes së institucionit (*për të cilin u fol më lart*), në përfundim të të cilit janë lënë detyrat përkatëse, për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë.

Nisur nga fryma e legjislacionit të shërbimit civil dhe nga përmbajtja e vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, në raste të tilla, kur mungon një zyrtar i nivelit raportues, apo një i tillë kundërfirmues, funksionet e tij i kalojnë menjëherë, zyrtarit më të lartë nga ana hierarkike. Në rastin konkret dhe në raste të tjera të ngjashme në këtë institucion, **procesi i vlerësimit duhej kryer drejtpërdrejt, prej drejtuesit të institucionit.** Në plotësimin e kësaj detyre, ai nuk ka pengesë që të mbajë parasysh edhe opinionet përkatëse, të nëpunësve që kanë kryer faktikisht, detyrat *“shtesë”*.

2. Akti i vlerësimit nga pikëpamja formale, nuk është kryer në respektim të kërkesave të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, pasi nuk është i plotësuar me komentet përkatëse në secilën prej zërave të vlerësimit. Kjo mangësi, e bën procesin subjektiv dhe të paargumentuar, duke krijuar mundësi që drejtuesit të mbajnë qëndrime arbitrare, duke marrë nëpër këmbë të drejtat e nëpunësve civilë, por dhe të kundraligjshëm, gjë që në vështrim të neneve 109, shkronja “c”, 113 dhe 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të RSH”*, përbën shkak për anulimin e aktit të vlerësimit dhe përsëritjen e gjithë procesit nga fillimi.

Sa më sipër, në analizë të dokumenteve shkresore të administruara dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi, Komisioneri arrin në përfundimin se, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2018, për nëpunësin *****, nuk është kryer sipas procedurës dhe kërkesave të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe në vendimin nr. 109, datë 27.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civilë”*, të ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 90, pika 1, të ligjit nr.

44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 16, pika 8 dhe nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit të AZHBR-së, të drejtojë procesin administrativ për anulimin e aktit të vlerësimit të nëpunësit *****, për periudhën Janar - Qershor 2018; përsëritjen e këtij procesi, duke kërkuar përmbylljen e tij nga ato autoritete të ngarkuar nga ligji, siç u përmend në pjesën arsyetuese të vendimit, brenda afatit që do të përcaktohet në vendimin e Komisionerit.

Formulari standard i vlerësimit të plotësohet me komentet përkatëse në rubrikat e tij, për të identifikuar aftësitë dhe dobësitë e nëpunësit civil, për të cilin bëhet vlerësimi, në mënyrë që të përmirësohet situata dhe të sugjerohen trajnime dhe mundësi të tjera për zhvillimin profesional të nëpunësit të vlerësuar.

2. Aktet administrative si dhe shënimet përkatëse që shoqërojnë këtë proces, duhet t'i njoftohen nëpunësit të interesuar dhe të bëhen pjesë e dosjes së personelit të nëpunësit civil.
3. Për realizimin e procesit të vlerësimit në fjalë, duhen të mbahen parasysh, përveç sa u thanë më sipër, edhe detyrat e lëna në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe vendimin paralajmërues, nr. 82, datë 4.10.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja e dëgjimit për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e nëpunësit civil, që nuk ka kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Të njoftohen për këtë vendim, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha